



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Skupstina Opstine
Municipal Istog

Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.212 /21

Datë: 18.05.2021

Duke u bazuar në Ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar të Republikës e Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.22/2013 për Numrin Maksimal të Nxënësve në Klasë dhe Raporti Mësimdhënës Nxënës, si dhe Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.16/2004 për Regjistrimin e Nxënësve në Klasën e Parë dhe parafillor në shkollë, Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit në Istog, shpall këtë:

K O N K U R S

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E PARË (I) DHE PARAFILLOR
NË SHKOLLA PËR VITIN SHKOLLOR 2021/22

Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë dhe parafillor për vitin e ri shkollor 2021/22 fillon me datën 18 maj 2021, në të gjitha shkollat fillore të Komunës së Istogut dhe zgjatë deri me 07.06.2021.

Kriter për regjistrim të nxënësit/ës në klasën e parë dhe parafillor është që fëmija të ketë mbushur moshën minimale (gjashtë vjet për klasë të parë) dhe, (pesë vjet për parashkollor) por mund të regjistrohet edhe nën moshën minimale të arsimit të detyruar në fillim të vitit shkollor me vlerësim të mjekut dhe të psikologut.

Dokumentacioni i kërkuar për regjistrim.

Për regjistrim në klasë të parë dhe parafillor, fëmiju (Prindi) duhet të sjellë certifikatën e lindjes jo më të vjetër së 6 muaj.

Informatat për procedurat e nevojshme për regjistrim mund t'i merrni në shkollat më të afërta nga vendbanimi.

Istog, 18.05.2021



Drejtori i DKA-së

Majrush Shoshi